

AKT THEMELIMI

Ne Tirane, sot me daten 26 Nëntor 2004, (dytije e kater), ditën e shtetasit :

1) Armand BREÇANI, i biri i Vladimirit dhe Vasilikes, lindur me 03.10.1973 dhe banues ne tirane, Bulevardi Zhan d'Ark, Kulla 1, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, ne perputhje me legjislacionin shqiptar, duke u mbeshtetur ne: Vullnetin tim të lire të plote e të sinqerte, dhe inisiativen e lire private, Ne Kushtetuten e Republikës se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, Ne ligjin 7638 date 19.11.1992, " Per shoqerite tregtare ", Ne ligjin nr. 7667 date 28.01.1993, " Per regjistrin tregtar", ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, krijoj shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, "A.S.C" shpk, Tirane Shqiperi.

NENI 1

Shoqeria tregtare, formohet nga ortaket e shoqerise me emrin "A.S.C" shpk Tirane, emertimi i të cilit do të jete i stampuar dhe ne vulen e saj.

NENI 2

Selia e shoqerise " A.S.C " shpk eshte ne qytetin e Tiranes, me adrese ne rruga e Kavajes, pallati perballe Zonjes se Keshillit te Mire.

NENI 3

Shoqeria e shtrin aktivitetin e saj tregtar ne të gjithe juridiksionin territorial të Republikës se Shqiperise si dhe jashte shtetit.

Me vendim të ortakeve, mund të krijohen ose anulohen (ne rast se jane celur), seli, filiale, agjensi dhe perfaqesi si ne qytete të tjera të Shqiperise dhe jashte saj.

Njesite e tjera strukturore të shoqerise si Dege apo perfaqesi dhe jashte shtetit krijojen kur nje gje të tille parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve të huaja, normat e se drejtes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

NENI 4

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke (njeqindmije), formuar dhe nenshkruar nga ortaku, i ndare ne 100 kuota, me vlere nominale 1 kuote / 1000 leke, i depozituar sipas ligjit dhe duke u zoteruar nga ortaku 100% te kapitalit themeltar. Ortaku ka pavaresi ligjore, ne baze te kuotave qe zoterojne, organizative si dhe të drejta pronesia mbi cdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi cdo lloj pasurie tjetër të fituar ne rruge të ligjshme. Shoqeria pergjigjet vetem me kapitalin e saj.



NENI 5

Kapitali nuk mund të jete kurre i perfaqesuar me letra me vlere dhe derdhja e kapitalit themeltar të shoqerise, behet para kerkeses se drejtuar Gjykates per njohjen dhe regjistrimin e saj si person juridik.

NENI 6

Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise eshte mbi 10 vjet, duke filluar ky afat nga dita e shpalljes se Vendimit të Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, per njohjen dhe regjistrimin e shoqerise si person juridik.

Me vendim të Ortakute, kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise mund të ndryshoje, dhe ky vendim i dergohet menjehere per depozitim Gjykates kopetente per të bere shenimet e nevojshme ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare.

NENI 7

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj tregtare ne perputhje të plote me Legjislacionin Shqiptar ne fuqi si dhe mbi bazen e ketij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.

NENI 8

Shoqeria cel llogari bankare ne leke vendi dhe cdo lloj valute, ne Banka vendase ose të huaja, private apo shteterore, me qellim per të kryer veprimet e nevojshme per ushtrimin dhe perballimin financiar të aktivitetit të saj.

Ortaket e Shoqerise ose administratori i caktuar prej tyre, depozitojne faksimilet e firmave të tyre orgjinale ne Bankat ku eshte celur llogaria dhe terheqja e pjeseve të saj behet kur ceku Bankar eshte firmosur nga ortaket dhe Administratori i shoqerise, ne rastin kur ortaket caktojn nje administrator dhe vetem me firmen e ortakeve, kur ata vete kryejne njekohesisht dhe detyren e Administratorit të Pergjithshem të shoqerise.

NENI 9

Pjeset e kapitalit themelor, jane lirisht të transferueshme ne rruge trashegimie sipas dispozitave të Kodit Civil.

Ortaket, kane të drejte të transferojne jashte territorit të Republikes se Shqiperise pjeserisht apo teresisht kontributet e tyre perfshire dhe fondet dhe kontributet nepjeseve të kapitalit themelor, duhet të jene të vertetuara me Akt Noterial dhe per nje gje të tille duhet të marre paraprakisht vendim nga Ortaku i Vetem.

Shoqeria dhe të tretet duhet të respektojne keto transferime sapa t'u behen të ditura.

NENI 10

Shoqeria krijohet per të ushtruar aktivitetin e saj ne :

Import-Eksporti dhe tregtimi me shumice e pakice kryesisht i kafese dhe i produkteve te saj. Import eksport, dhe tregtim me shumice e pakice të mallrave të ndryshme industriale, ushqimore, elektronike, informatike, artikuj mobilerie, hidrosanitare, materiale ndertimi.

NENI 11

Me vendim të Ortakut të Vetem, shoqëria mund të zgjerohet aktivitetin e saj tregtar dhe në drejtimit të tjera të cilat janë me interes për mbarvajtjen e shoqërisë.

NENI 12

Me vendim të Asamblesë së ortakëve, shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose më shumë ortakë të tjerë, shtetas shqiptarë apo të huaj, ose të bashkohet me një shoqëri tjetër tregtare si brenda vendit dhe jashtë saj.

NENI 13

Ortaku i Vetem është Organi më i Lartë Drejtues dhe Vendimor i shoqërisë dhe ai ushtron të gjitha kompetencat që ligji "Për shoqëritë tregtare" i njeh ortakut të vetem. Ortaku mund t'ia delegojë kompetencat një ose më shumë administratorëve të caktuar prej tij ose dhe një personi fizik jashtë ortakërisë së shoqërisë, vetëm mbi bazën e prokures.


NENI 14

Administratori i përgjithshëm i shoqërisë "A.S.C" shpk, emërohet Z.Armand Breçani.

NENI 15

Ky akt themelimi u redaktua në 4 ekzemplare, vetëm në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike dhe ai është i vlefshëm kur vertetimi i autenticitetit të nënshkrimit është bërë nga Noteri.

THEMELUESIT E SHOQËRISË TREGTARE "A.S.C" SHPK


Z. Armand BREÇANI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 7295 Rep.

Nr. 1579 Kol.

NOTER

EMRI RUKO SAKO
ADRESA RRUGA E DURRESIT
ligjore

Vertetesi

VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane, sot me date 26 nentor 2004 (dymije e kater), ditën e Premte, para meje Noterit Publik Ruko SAKO, anetare e Dhomes se Notereve Tirane, u paraqit personalisht shtetasi me keto identitete :


Armand BREÇANI, i biri i Vladimirit dhe Vasilikes, lindur me 03.10.1973 dhe banues ne tirane, Bulevardi Zhan d'Ark, Kulla 1, Administrator i Shoqerise me pergjegjesi te Kufizuar "A.S.C" shpk,

Shtetasi eshte madhor dhe me zotesi të plote juridike per të vepruar.

Me vullnetin e tij të lire e të plote dhe të singerte ka redaktuar jashte kesaj zyre ne gjuhen shqipe, ne kater ekzemplare me permbajtje dhe vlera të njejta juridike, me cilesine e Ortakut të vetem të shoqerise "A.S.C." shpk, Aktin e Themelimit të kesaj shoqerie tregtare perbere nga 15 nene të dhe pasi e lexoi ate e nenshkroi pa verejtje duke shkruar emrin mbiemrin dhe firmen orgjinale të tij ne kete zyre dhe para meje Noterit.

Une Noteri vertetetoj rregullsin dhe bazueshmerine e redaktimit ne ligj të ketij Akti Themelimi si dhe autenticitetin e nenshkrimeve, me cilesine qe me njeh Ligji nr. 7829, date 01.06.1994. " Per Noterin " ne Republikën e Shqiperise.

NOTERE
RUKO SAKO



STATUT
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"A.S.C." SHPK

Ne baze te ligjit nr. 7638, date 19 Nentor 1992 "Per Shoqerite Tregtare ne Republiken e Shqiperise" dhe te akteve te tjera ligjore, ne Tirane, sot, me date 10 nentor 2004 (dymije e kater), ortaku

1) Armand BREÇANI, i biri i Vladimirit dhe Vasilikes, lindur me 03.10.1973 dhe banues ne Tirane, Bulevardi Zhan d'Ark, Kulla 1, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, me vullnetin e tij te lire e te plote, ne perputhje me legjislacionin shqiptar, vendos te krijoj **Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuara "A.S.C." shpk.**

KREU I
DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuara "A.S.C" shpk Tirane, eshte person juridik i pavarur, ka te drejta dhe detyrime per te cilat pergjigjet brenda kufijve te percaktuara ne ligjin nr.7638, date 19 Nentor 1992 si dhe akteve te tjera ligjore.

Neni 2

Shoqeria e ushtron veprimtarine e saj private ne baze te ekonomise se tregut te lire.

Neni3

Themeluesi i Shoqerise ne kete sipermarrje kane derdhur kapitalin e tij, me qellim qe te perfitoje te ardhurat qe mund te vijne nga veprimtaria private si dhe te perballoje humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit ne kapitalin fillestar.

Neni 4

Shoqeria "A.S.C" shpk Tirane eshte person juridik dhe fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane dhe me pajisjen me lejen e ushtrimit te profesionit nga organi kompetent.


EMRI, QENDRA, TERRITORI

Neni 5

Emertimi i Shoqerise do te jete: **Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuara "A.S.C" shpk.**

Neni 6

Selia e Shoqerise eshte ne rrugen e Kavajes, pallati perballe Zonjes se Keshillit te Mire - Tirane. Shoqeria mund te zhvilloje aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikës se Shqiperise dhe jashte saj.



OBJEKTI

Neni 7

Objekti i veprimtarise se kesaj shoqerie do te jete:

Import-Eksporti dhe tregtimi me shumice e pakice kryesisht i kafese dhe i produkteve te saj. Import eksport, dhe tregtim me shumice e pakice të mallrave të ndryshme industriale, ushqimore, elektronike, informatike, artikuj mobilerie, hidrosanitare, materiale ndertimi.

AFATI I VEPRIMTARISE

Neni 8

Aktiviteti privat i shoqerise do te zhvillohet me nje afat te pacaktuar, mbi 10 vjet.

Neni 9

Shoqeria eshte e detyruar te mos ndryshoje destinacionin e saj. Ndryshimi i destinacionit te veprimtarise ekonomike financiare, mund te behet me lejen e organeve perkatese.

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 10

Kapitali themeltar i Shoqerise "A.S.C" shpk eshte 100.000(njeqindmije) Leke dhe perbehet nga kontributi fillestar i themeluesit te shoqerise duke zoteruar 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kapitali mund te rritet me zhvillimin e veprimtarise ekonomike financiare te shoqerise.

Neni 11

Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere te tregtueshme. Transferimet e kapitalit themeltar duhet te vertetohen me akt noterial.

Neni 12

Shoqeria apo te tretet duhet te respektojne keto transferime sapo t'i behen te ditura asaj.

Neni 13

Pjeset e kapitalit themeltar jane te transferueshme ne rruge trashegimie. Ato jane lirisht te transferueshme ne rast ndarje pasurore mes bashkeshorteve, paraardhesve dhe pasardhesve.

Neni 14

Pjese te kapitalit themeltar mund t'i transferohen edhe personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri, me miratim te Ortakeut te Vetem.

Neni 15

Ne rast te shtimit te numrit te ortakeve, me marrveshje, pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferushme midis tyre.

DREJTIMI ADMINISTRATIV

Neni 16



Shoqëria mund të administrohet nga një ose disa persona fizike (administratore), siç do të caktohen nga ortakët që përfaqësojnë me tëper se gjysmën e pjeseve të kapitalit.

Shoqëria "A.S.C" shpik do të ketë si administrator Z.Armand Breçani.

Neni 17

Administratori ka për detyrë organizimin dhe drejtimin e shoqërisë. Ai mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.

Neni 18

Në marrëdhënie me të tretet administratori angazhon shoqërinë nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj të veprimtarisë. Në rastet kur administratori është i emëruar nga themeluesit e shoqërisë, kryen të gjitha veprimet e administrimit të shoqërisë, me përjashtim të atyre që janë në kompetencën e themeluesit të shoqërisë.

Neni 19

Administratori e humbet detyrën e ngarkuar në rast të prishjes së shoqërisë ose kur shkarkohet nga Ortaku i Vetëm. Në rastin e fundit, shkarkimi i administratorit bëhet në bazë të një akti me shkrim të ortakut të shoqërisë. Në rast se shkarkimi bëhet me pa të drejtë ai le shkak për dëmshpërblim financiar.

PERGJEGJESITË LIGJORE TË ADMINISTRATORIT

Neni 20

Administratori është përgjegjës individualisht ose solidarisht sipas rastit ndaj shoqërisë ose ndaj të treteve për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajet të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Raporti i administrimit, inventaret dhe llogaritë vjetore të hartuara nga administratorët, i nënshtrohen miratimit të ortakut brenda një afati prej 6 muajsh duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar.

Neni 21

Ortaku i Shoqërisë ka kompetencë:

Të miratojë programin e shoqërisë, të hartojë, raportin e administrimit, inventaret, llogaritë vjetore, të cilat hartohen brenda një afati 6 muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar.

Vendos për shpërberjen e shoqërisë;

Vendos për fitimet dhe mbulimin e humbjeve;

Rregullon marrëdhëniet e punësimit dhe shpërblimit brenda shoqërisë;

Sipas akteve ligjore shlyen detyrimet ndaj organeve shtetërore, personave juridike e fizike, vendas apo të huaj.

E të tjera.

VENDIMET E ORTAKU TË VETËM

Neni 22



Vendimet merren nga Ortaku i Vetem.

KREU II
MARRDHENIET EKONOMIKO-FINANCIARE
Neni 23

Shoqeria "A.S.C" shpk mund te lidhe kontrata me sektoret shteterore, drejtperdrejt me tregun e lire si dhe me persona juridike e fizike, vendas a te huaj, sipas legjislacionit ne fuqi.

Neni25

Ne veprimet kontraktuale shoqeria perfaqesohet nga administratori ose nga persona te tjere te autorizuar prej tij.

Neni 26

Te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga kontratat jane te detyrueshme per shoqerine dhe punonjesit e saj.

Neni 27

Sipas rregullave te caktuara nga Ministria e Financave dhe te akteve te tjera ligjore, shoqeria pergjigjet per kontributin fiskal, afatet e derdhjes se tyre, detyrimet ndaj shtetit, sigurimet shoqerore etj. Sipas ligjit te tatimit mbi fitimin percaktohen tatimet per veprimtarine e shoqerise. Shoqeria ka te drejte te çele llogari likujduese prane bankave te vendit, te huaja ne Shqiperi dhe te kryeje veprimet e likujdimit nepermjet tyre.

Neni 28

Per sigurimin e veprimtarise ekonomike shoqeria ka te drejte te vetfinancohet ne leke ose valute te huaj.

Neni 29

Shkembimin e monedhes shqiptare me monedhe te huaj e anasjelltas, mund te beje ne perputhje me kursin e caktuar Banka e Shtetit Shqiptar ose me tregun e lire privat te valutes.

Neni 30

Te ardhurat nga veprimtaria private do te sigurohen sipas çmimeve qe i cakton vete shoqeria. Çmimet dhe tarifat do te caktohen sipas kerkeses dhe ofertes.

Neni 31

Shoqeria ka te drejte te transferoje jashte shtetit kapitalin dhe pjesen e saj te fitimit ne valute. Per pjesen e fitimit qe transferohet jashte shoqeria paguan nje tatim te caktuar ne dispozitat perkatese te legjislacionit shqiptar.



Neni 32

Per pasqyrimin e aktivitetit tregtar administratori ose persona te tjere te caktuar nga ortakët, jane te detyruar te mbajne dokumentacion te rregullt financiar dhe regjistrat perkates sipas ligjit te veçante.

Neni 33

Veprimtaria ekonomike e shoqerise mbaron ne muajin dhjetor te çdo viti. Administratori eshte i detyruar te paraqese bilance periodike, bilance vjetore se bashku me deklaraten e fitimeve dhe humbjeve dhe t'i depozitoje ato ne organin financiar te juridiksionit perkates ku ushtron aktivitetin shoqeria.

**KREU III
MARRDHENIET E PUNESIMIT**

Neni 34

Themeluesi i shoqerise vendos per shtimin e numrit te ortakeve dhe personave te tjere qe do te punesohen ne veprimtarine e shoqerise "A.S.C" shpk.

Neni 35

Marrdheniet e punesimit brenda shoqerise rregullohen sipas kontrates qe lidhet lirisht midis paleve. Kontrata leshohet nga administratori i shoqerise pasi te jete marre me pare pelqimi i ortakut te shoqerise.

Neni 36

Marrja ne pune nga punedhenesi behet me regjistrimin e punonjesve ne librin e punes se shoqerise si dhe duke njoftuar organet e punes te juridiksionit ku ushtron aktivitetin shoqeria.

Neni 37

Ortakut, administratorët dhe punonjesit e tjere te shoqerise jane te detyruar te respektojne disiplinen e punes dhe mbajne pergjegjesi per thyerjen e saj.

Neni 38

Ndaj personave qe demtojne pronen e shoqerise zbatohen masa ndeshkimore te cilat percaktohen nga themeluesi i shoqerise dhe ne mungese te tij zbatohen dispozitat e Kodit te Punes ne Republikene Shqiperise.

Neni 39

Kontrata e punes mund te lidhet me ose pa afat te caktuar, sipas kriterëve te caktuara nga ortaku i shoqerise dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar (Kodin e Punes).

Neni 40

Punonjesit e gezojne lejen vjetore dhe lejen plotesuese sipas kriterëve te percaktuara ne kontraten e punes dhe ne mungese te tyre sipas kodit te Punes se Republikës se Shqiperise.



Neni 41

Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punes behet ne baze te nje akti me shkrim te leshuar nga Ortaku i Vetem i Shoqerise. Largimi lidhet me mbarimin e kontrates se punes, per shkak te shkeljeve disiplinore ne pune ose me vete kerkesen e te punesuarit.

Neni 42

Punonjesi qe largohet ose punesohet ne nje pune tjeter, duhet te dorezoje detyren ne baze te nje akti me shkrim, pasi te kete likujduar detyrimet monetare dhe materiale. Akti i mesiperm mbahet nga Administratori i Shoqerise.

ELEMENTE TE TJERA

Neni 43

Per zhvillimin dhe zgjerimin e veprimtarise, shoqeria mund te marre truall per ndertim, me qira ose ne pronesi, si dhe objekte te ndertuar sipas nje kontrate te veçante.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

Neni 44

Te ardhurat neto, pas shlyerjes se detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqerore, etj, kalojne ne pronesi te ortakut te vetem te shoqerise.

Neni 45

Shperblimi per administratorin dhe personat e punesuar ne veprimtarine e Shoqerise "A.S.C" shpk Tirane caktohet sipas kontrates se punes. Ndryshimi ne pagese caktohet nga Themeluesi i shoqerise.

Neni 46

Shoqeria perballon humbjet vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit fillestar ne kapitalin baze.

Neni 47

Fitimi qe do te shperndahet perbehet nga fitimi i vitit financiar, te cilit i jane zbritur ose shtuar numrat respektive te humbjeve apo fitimeve te bartura nga vitet e meparshme.

Neni 48

Kur pushon aktiviteti i shoqerise, kapitali i mbetur, pasi shlyen te gjitha detyrimet, takon ortakut te shoqerise.

Neni 49

Fitimi i mbetur kalon ne pronesi te ortakut pasi jane shlyer te gjitha detyrimet tatimore si dhe pagesat e mundshme per punonjesit e shoqerise.

SHPERBERJA E SHOQERISE

Neni 50

Ne rast se kapitalet e shoqerise per shkak te humbjeve te konstatuara ne dokumentat financiare rezultojne me te vogla se gjysma e kapitalit themeltar, ortaku vendos brenda 4 muajve nga dita e konstatimit mbi mundesine e prishjes se parakohshme te shoqerise dhe mund te kerkoje ne gjykate prishjen e saj.

Neni 51

Gjykata mund t'i ofroje shoqerise nje afat maksimal prej 6 muajsh per te rregulluar gjendjen. Ajo nuk mund te prishe shoqerine ne rast se ky rregullim eshte bere ditën ne te cilen ajo mblihet per te marre vendim.

Neni 52

Ne rast se shoqeria nuk priset, detyrohet te zvogeloje kapitalin e saj ne nje vlere jo me te vogel se ajo e humbjeve qe ka mbetur pa mbuluar, duke patur parasysh qe shuma e mbetur te jete mbi 100.000(njeqindmije) Leke.

DISPOZITA E FUNDIT

Neni 53

Themeluesi ne rastin e shtimit te numrit te ortakeve ka te drejten te beje ndryshimet e nevojshme ne statut si dhe te hartoje kontraten e perbashket me ortaket e tjere, duke bere ndryshimet e nevojshme ne regjistrin tregtar prane Gjykates se Shkalles se Pare.

Neni 54

Mosmarrveshjet e shoqerise ne marrdheneie me persona juridike e fizike, vendas e te huaj, zgjidhen ne mirkuptim, ne te kundert, kur kjo nuk arrihet, zgjidhen nga Gjykata e Shkalles se Pare Tirane.

Neni 55

Per sa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet ligjit nr.7638, date 19 Nentor 1992 "Per Shoqerite Tregtare ne Republiken e Shqiperise" si dhe çdo akti tjeter te legjislacionit shqiptar.


Neni 56

Statuti perpilohet ne kater kopje per t'iu dorezuar organeve kompetente. Nje kopje e tij mbetet si pjese perberese e dokumentacionit te formimit te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuara "A.S.C" shpk Tirane.

ORTAKET E SHOQERISE

"A.S.C" shpk


Z. Armand BREÇANI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 7296 Rep.

Nr. 1580 Kol.

NOTER

EMRI

ADRESA

ligjore

RUKO SAKO

RRUGA E DURRESIT

Vertetesi

VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane, sot me date 26 nentor 2004 (dymije e kater), ditën e Premte, para meje Noterit Publik Ruko SAKO, anetare e Dhomes se Notereve Tirane, u paraqit personalisht shtetasi me keto identitete :

Armand BREÇANI, i biri i Vladimirit dhe Vasilikes, lindur me 03.10.1973 dhe banues ne tirane, Bulevardi Zhan d'Ark, Kulla 1, Administrator i Shoqerise me pergjegjesi te Kufizuar "A.S.C" shpk,

Shtetasi eshte madhor dhe me zotesi të plote juridike per të vepruar.

Me vullnetin e tij të lire e të plote dhe të sinqerte ka redaktuar jashte kesaj zyre ne gjuhen shqipe, ne kater ekzemplare me permbajtje dhe vlera të njejta juridike, me cilesine e Ortakut të vetem të shoqerise "A.S.C." shpk, Statutin e kesaj shoqerie tregtare perbere nga 56 nene dhe pasi e lexoi ate e nenshkroi pa verejtje duke shkruar emrin mbiemrin dhe firmen orgjinale të tij ne kete zyre dhe para meje Noterit.

Une Noteri vertetoj rregullsin dhe bazueshmerine e redaktimit ne ligj të ketij Akti Themelimi si dhe autenticitetin e nenshkrimeve, me cilesine qe me njuh Ligji nr. 7829, date 01.06.1994. " Per Noterin " ne Republiken e Shqiperise.

PULLE TAKSE



NOTERE
RUKO SAKO

